



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

Studim: “Përshtatshmëria e aksesioneve të Shegës të mbjellë në koleksionin autokton të pemëve frutore”.

1. Hyrje

Vendi ynë ka kushte shumë të përshtatshme për prodhimin e frutave të shegës. Kultivimi i shegës nga shumë familje të zonës së ultësirës bregdetare, nga Malësia e Madhe deri në Sarandë, tregon për mundësinë e kultivimit të saj në këto zona.

Shega është një nga drufrutorët e cila ka disa karakteristika dhe paraqet disa veçori që i japin asaj përparësinë për një përhapje më të gjerë.

Pema e shegës dhe pse ka potencial të madh, vetëm 10% e këtyre pemëve janë të përdorshme.

Vitet e fundit shega ka marrë zhvillim të madh për vet cilësitë e shkëlqyera që ajo ka. Mbjellja në masive e kultivarëve të huaj duke anashkaluar kultivarët e vendit të cilët janë përshtatur më së miri në kushtet klimatiko-tokësore të rajoneve ku janë mbjellë është një fenomen që vihet re shpesh.

Grumbullimi i një pjese të bimëve të shegës në rajone të ndryshme që paraqesin karakteristika interesante janë mbjellë në vitin 2010, në bazën eksperimentale Shamogjin.

Këto bimë të gjetura janë rezultat i punës së specialistëve të QTTB Vlorë, gjatë eksplorimeve për përzgjedhjen e bimëve autoktone në zona të ndryshme të Shqipërisë.



2. Materiali dhe metoda

Në koleksionin e pemëve frutore autoktone i cili zë një sipërfaqe prej 1 Ha me 17 Specie, një vend të rëndësishëm zënë dhe aksesionet e shegës. Janë gjithsej 9 aksesione të ndyshme të shegës

Studim i ngritur ka si qëllim: përshtatshmërinë e këtyre aksesioneve të sjella nga zona të ndryshme eksplorimi.

3. Treguesit e marrë në studim janë

I. Fenofazat e zhvillimit të bimës

1. Fenofaza e lulëzimit për çdo aksesion
2. Përshkrimi i pemës.

II. Të dhëna mbi frutin

3. Të dhëna biometrike të frutit
4. Të dhëna kimike (% e sheqerit)

3.1 Fenofaza e lulëzimit për çdo aksesion

Për çdo aksesion janë mbajtur shënime përkatëse mbi kohën e lulëzimit.

Eshtë quajtur fillim lulëzimi kur kanë çelur 15% e luleve dhe përfundimi i kësaj periudhe kur kanë çelur mbi 80% e luleve.

Tabelë 1. Koha e lulëzimit të aksesioneve të shegës

Emri i aksesionit	MAJ														Qershor				
	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	1	2
Shege e ëmbël e Ndroqit																			
Shega majoshe e Tiranës																			
Shegë majoshe e Mifolit																			
Shega kokërr vogël																			
Shega kokërr madhe																			
Shega Devedishe																			
Shega e ëmbël																			
Shegë e ëmbël e Mifolit																			
Shega Stambollesha																			

4. Përshkrimi i shkurtër

1. SHEGA E ËMBEL E NDROQIT



Pema me zhvillim mesatar. Formë e çrregullt. Lulëzimi i madh. Fruti pa plasaritje të lëkurës.

Pesha mesatare e kokrrës	218 gr
% e sheqerit në frut	16.3
Aciditeti (%) në frut	0.53
Raporti T/k	0.7
Periudha e pjekjes	15/10-20/10

SHEGA MAJOSHE E TIRANËS



Pema me zhvillim mesatar. Formë e pemës jo e rregullt, tenton të zhvillohet në lartësi lulëzimi mesatar. Fruti pa plasaritje të lëkurës.

Pesha mesatare e kokrrës	238.5 gr
% e sheqerit në frut	17.3
Aciditeti (%) në frut	0.453
Raporti T/k	0.54
Periudha e pjekjes	15/10-25/10

SHEGA MAJOSHE E MIFOLIT



Pema me zhvillim mesatar. Formë jo e rregullt, lulëzimi madh. Fruti me plasaritje të lehta të lëkurës në periudhën e vjeljes së prodhimit.

Pesha mesatare e kokrrës	224 gr
% e sheqerit në frut	16.7
Aciditeti (%) në frut	0.77
Raporti T/k	0.9
Periudha e pjekjes	15/10-20/10

SHEGA KOKËRR VOGËL



Pema me zhvillim mesatar. Formë e çrregullt me shumë degëzime të cilat dalin nga fundi i pemës. Lulëzimi mesatar. Fruti i vogël pa plasaritje të lëkurës.

Pesha mesatare e frutit	147.4 gr
Pesha mesatare e kokrrës	0.34gr
% e sheqerit në frut	0.52
Raporti T/k	1.34
Periudha e fillimit të pjekjes	15/10-25/10

SHEGA KOKËRR MADHE



Pema me zhvillim mesatar. Formë e çrregullt me tendencë të zhvillimit të degëve në drejtim anësor. Lulëzimi i madh. Fruti me plasaritje të lëkurës.

Pesha mesatare e kokrrës	281.3 gr
Pasha e kokrrës	0.49
% e sheqerit në frut	16
Aciditeti (%) në frut	2.03
Raporti T/k	0.79
Periudha e pjekjes fillon	20/10-20/10.

SHEGA DEVEDISHE





Pema me zhvillim të madh. Pema tenton të zhvillohet në lartësi. Lulëzimi i madh. Fruti pa plasaritje të lëkurës në periudhën e pjekjes.

Pesha mesatare e frutit	263.9 gr
Pasha mesatare e kokrrës	0.44
% e sheqerit në frut	17
Aciditeti (%) në frut	0.48
Raporti T/k	1.10
Periudha e pjekjes	15/10-20/10

SHEGA E ËMBËL E MIFOLIT



Pema me zhvillim mesatar, tenton të zhvillohet në gjerësi. Lulëzimi i madh. Fruti me plasaritje të lëkurës në periudhën e vjeljes.

Pasha mesatare e frutit	374.4 gr
% e sheqerit në frut	14.2
Aciditeti (%) në frut	1.64
Raporti T/k	1.2
Periudha e pjekjes	15/10-20/10

SHEGA E ËMBEL TRUP VOGËL



Pema me zhvillim të vogël. Formë e çrregullt që tenton të zhvillohet në gjerësi. Lulëzimi i madh. Fruti pa plasaritje të lëkurës.

Pesha mesatare e kokrrës	318 gr
% e sheqerit në frut	18.3
Aciditeti (%) në frut	0.59
Raporti T/k	0.7
Periudha e pjekjes	15/10-20/10

SHEGA STAMBOLLESHE



Pema me zhvillim të madh. Formë e çrregullt që tenton të zhvillohet në gjerësi. Lulëzim i madh. Fruti pa plasaritje të lëkurës.

Pesha mesatare e frutit	416 gr
% e sheqerit në frut	16.3
Aciditeti (%) në frut	2.17
Raporti T/k	0.48
Periudha e pjekjes	15/10-20/10.

Specialistët:

Athina Llambro

Adhurim Lazaj

Lumturi Xhelilaj

Ornela Boçova